



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2827

NR. VENDIMI 4882



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

Nr. 10095/2827 Regj.Themeltar
Nr. 4882 Vendimi
Data e regjistrimit 21.06.2019
Datë 10.11.2020

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e përbërë nga trupi gjykues:

Gjyqtar Julian HAXHIU

me asistencen e sekretares gjyqesore Klaudia ABAZAJ, sot me datë 10.11.2020, ne seance gjyqesore me dyer te hapura mori ne shqyrtim ceshtjen civile me Nr.10095/2827 Regj.Them qe i perket paleve:

PADITES: Shoqata *** me adrese ***, perfaqesuar nga avokati *** me prokure te posacme.

PALA E PADITUR: Subjekti *** me adrese ***, perfaqesuar nga avokati ***.

OBJEKTI: Detyrimin e pales së paditur *** Nipt *** për të kryer pagesat vjetore për të drejtat e autorit si me poshte: Pagesen për vitin 2017 sipas Faturës Tatimore të Shitjes Nr. *** date *** në vlerën *** Lekë.

Detyrimin e pales së paditur për të paguar shpenzimet gjyqesore, avokatore.

BAZA LIGJORE: Neni 31, 42, 43, 153, 154, 154/a, te K.Pr.Civile, nenet 420, 422, 445, 476, 481/1, 676 te K.Civil, neni 2, neni 130 e vijues, neni 138 e vijues, neni 142, neni 162, neni 166 te Ligjit Nr. 35/2016 date 31.03.2016 per “Te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to” neni 107 ligji Nr.9380 date 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, i ndryshuar.

Gjykata konstatoi se çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencë të kësaj Gjykate, shqyrtoi provat dhe dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan:

Përfaqësuesi i paditësit kërkoi pranimin e kërkesë- padisë,
Pala e paditur, ne mungese

VËREN

Se paditësi i është drejtuar Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tiranë dhe ka kërkuar detyrimin e pales së paditur *** Nipt *** për të kryer pagesat vjetore për të drejtat e autorit si me poshte: Pagesen për vitin 2017 sipas Faturës Tatimore të Shitjes Nr. *** date *** në vlerën *** Lekë.

Nga hetimi gjyqesor rezultoi e provuar se:

*** është një shoqatë që funksionon si një organizatë mbledhëse e të drejtave të autorëve, kompozitorëve dhe botuesve të veprave artistike, letrare, muzikore e audiovizuale. Themeluar në vitin 1998 si shoqatë e autorëve, kompozitorëve, artistëve. *** , është licencuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës Nr. *** datë *** , botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65 datë 29.04.2015 dhe Licence Nr. *** , datë *** . Ajo është regjistruar si përfaqësuesja e vetme e të drejtave të krijuesve në Republikën e Shqipërisë sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar me ligjin 35/2016 datë 31.03.2016. Me Urdhërin Nr. *** , datë *** nga Ministri i Kulturës, *** rilicencohet edhe për tre vitet në vijim me anë të licenses Nr. *** date *** .

*** gjithashtu është anëtar i Konfederatës Botërore të Shoqërive të Autorëve CISAC duke realizuar mbrojtjen e të drejtave të autoreve shqiptarë në sistemin botëror në bazë territori si dhe anasjelltas përfaqësimin e mbrojtjen e veprave të mbrojtura e të drejtave të autorëve të huaj të rregjistruar në këtë sistem botëror në territorin e Republikës së Shqipërisë. *** mbron dhe përfaqëson në territorin shqiptar pothuajse gjithë titullarët e rregjistruar në sistemin e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit si dhe në këtë cilësi ajo përfaqëson të drejtat pasurore për përdorimin dhe shfrytëzimin e veprave të autorëve për të gjithë këta titullarë, lidhur me “çdo lloj e mënyrë përdorimi e shfrytëzimi” të tyre nga cilido subjekt në territorin shqiptar, ashtu siç përcakton kuadri ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sipas palës paditëse në rastin konkret, në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezulton se pala e paditur *** Shpk Nipt *** kryen aktivitetin me objekt “ Bar Bufe, Restorant, Hoteleri etj.” nuk ka kryer pagesat për të drejtën e autorit per vitin 2017 në vlerën *** Lekë, vlerë kjo e përlllogaritur në bazë të Vendimit nr 3 datë 04.08.2017 i KKDA “Për Miratimin e Metodologjise dhe Masës së Tarifave të Shpërblimit të Veprave të Mbrojtura nga e Drejta e Autorit në Sistemin e Administrimit Kolektiv”. Me shkresën “Njoftim per likujdim detyrimi” date *** , për të cilën pala e paditur ka marrë dijeni sipas letrës së porositur, i është kërkuar likujdimi i detyrimit Për të drejtat e autorit per vitin 2017, por nuk është marre asnje mase per permbushjen e detyrimit. Në këto kushte, pala e paditur shoqëria *** Shpk Nipt *** nuk ka permbushur detyrimin ligjor per pagesen vjetore te te drejtes se autorit per vitin, 2017 duke shkelur (duke moszbatuar) kështu dispozitat e Ligjit 35/2016 “Për të Drejtën e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me to”,

Pala e paditur, në deklaratën e mbrojtjes dhe gjate shqyrtimit gjyqësor ka pohuar faktin se ka deklaruar prane Drejtorise se Tatimeve ne muajn nëntor 2017 Faturen Nr. *** date ***Nr. Serie *** me shitës *** dhe pale blerese subjektin “*** shpk” ne vleren *** Lekë, vlerë te cilen e ka likujduar duke e provuar kete me mandat arketimin e dates 08.11.2017 dhe pretendon se pales se paditur nuk i ka mbetur me asgje per te paguar. Nisur nga fakti se pala e paditur ka pranuar duke e deklaruar prane organeve tatimore dhe duke likujduar faturen nga *** , ky është një pohim gjyqësor që vërteton faktin se

pala e paditur ka qenë përdorues i veprave audiovizuale të mbrojtura nga legjislacioni për të drejtën e autorit, duke likujduar një nga 3 agjencite kolektive të mbledhjes së të drejtave të autorit. Në rastin konkret pala e paditur ka kryer pagesën e të drejtës së autorit për producentet (***) dhe nuk ka likujduar pagesën vjetore për *** si agjencia që mbledh detyrimet për tekstshkruesit dhe kompozitorët, e cila është detyrim i cdo subjekti përdorues i të drejtës së autorit. Bazuar në nenin 138 të Ligjit Nr.35/2016 datë 31.03.2016 për “Të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” agjencite e të drejtave të autorit duhet të bien dakort për krijimin e sportelit unik, ku të transferojnë funksionet e mbledhjes së të gjitha tarifave të të gjitha kategorive pra: a) tarifën për agjencinë e të drejtës së autorit (***) që përfshin kompozitorët dhe tekstshkruesit), b) tarifën për agjencinë e të drejtave të producentëve (që është Agjencia e Mbrojtjes Interpretuesve), c) tarifën për agjencinë e mbrojtjes së të drejtave të prodhuesve (***)).

Këto kompetenca të agjencive janë deleguar me anë të Vendimit Nr.4 datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to drejt njëjës prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit-SUADA. Pra para kësaj datë kompetencën për mbledhjen e të drejtave të autorit e kishin tre agjencite e sipërpërmendura. Fakti që pala e paditur ka kryer likujdimin Për të drejtat e autorit, për ***, vërteton që kanë qenë përdorues të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe kanë detyrimin ligjor për të likujduar dhe tarifën vjetore të *** e cila është përlogaritur në bazë të legjislacionit në fuqi në vlerën ***Lekë.

Neni 138 i Ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” parashikon se : Përqindja e ndarjes së tarifës dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve, do të jetë si më poshtë:

40 % do të shkojë agjencisë përfaqësuese të të drejtave të autorit; Agjencia ***

30 % do të shkojë agjencisë përfaqësuese të të drejtave të interpretuesve; ***.

30 % do të shkojë agjencisë përfaqësuese të të drejtave të prodhuesve. ***.

Në këtë dispozitë ligjore citohet: Dispozitat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk do të zbatohen për ritransmetimin kabllor, kur ajo ka të bëjë me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv në lidhje me transmetimet e veta, pavarësisht nëse të drejtat në fjalë janë të vetat ose i janë transferuar asaj nga mbajtësit e tjere të të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të. Kjo dispozitë është e zbatueshme për subjektet e ritransmetimit kabllor kur ka të bëjë me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, dhe subjekti ***, bazuar në fushën e veprimtarisë së aktivitetit nga ekstrakti i QKB, nuk rezultojnë të jete ofrues të shërbimit mediatik audioviziv, por ushtron aktivitetin me objekt “Bar, Bufë, Restorant, Hoteleri etj.”.

Bazuar në faktin se pala e paditur *** Shpk ka kryer likujdimin e një prej Agjencive të Licensuara nga Ministria e Kulturës për mbledhjen e të drejtave të autorit, konkretisht për producentet, vërteton faktin që ky subjekt është përdorues i veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe ka detyrimin ligjor për pagesën për Agjencinë *** në vlerën *** Lekë, vlerë e cila korrespondon me *** % të vlerës së pagesës së të drejtës së autorit, sipas nenit 138 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

Pala e paditur ka kërkuar që padia duhet të rrëzohet si e pambështetur në ligj dhe në prova. Sipas palës së paditur, pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë prove shkresore nepermjet se ciles te vertetoje faktin e pretenduar prej saj se, palet jane perfshire nje marredhenie kontraktore ne fushen e shitjes(perdorimit) te te drejtave te autorit. As nuk ka permendur se cilat jane konkretisht keto te drejta autori. Dhe nje provë e tille shkresore nuk ekziston ne rrethin e provave. Nuk ekziston një kontratë me shkrim. Palet ndergjyqese asnjehere nuk kane nenshkruar nje kontrate me shkrim per shitje te nje malli konkret apo te nje sherbimi konkret per vitin 2017. Fatura tatimore e shitjes Nr. *, date *** eshte false. Sa i takon fatures tatimore te shitjes Nr. ***, date *** me Nr. serie ***, vleresojme se kjo fature nuk eshte vulosur dhe as nuk eshte nenshkruar nga ana e blesesit subjektit “****” shpk, konkretisht nuk eshte firmosur nga ana e z. *** si administrator dhe as nuk ka vulen e subjektit bleses.**

Sipas palës së paditur nuk rezulton që subjekti “**” sh.p.k të jetë pajisur me këtë fature, as ta ketë nënshkruar atë, si dhe nuk rezulton që kjo faturë të jetë deklaruar në Librin e Blerjeve te muajit Shtator – Dhjetor të vitit 2017 te subjektit “****” shpk prane Drejtorise Rajonale te Tatimeve Tirane, siç e tregojnë Librat e Blerjeve për periudhen shtator 2017 – dhjetor 2017 qe ndodhen bashkelidhur shkreses Nr. *** prot, date *** te DRT Tiranë. Në Librin e Blerjeve te muajit Nëntor 2017 ekziston Fatura Nr. ***, date *** me Nr. Serie *** me shitës *** dhe bleses subjektit “****” shpk ne vleren *** Lekë me TVSH, e cila ndryshon sa i takon subjektit shites dhe vleres se shitur. Rezulton se me mandat arketimin e dates *** prane *** Bank nga ana e pales paditëse është shlyer plotësisht kjo faturë në shumën *** Lekë, keshtu qe pales paditëse nuk i ka mbetur me asgje per te paguar.**

Sipas palës së paditur nga një vështrim i Faturës Nr. *, date *** me Nr. serie *** me vlere *** Lekë me TVSH në raport me faturen tjetër Nr. ***, date *** me Nr. serie *** me shumen *** Lekë me TVSH, vërehet shumë qartë se ato janë plotesuar nga e njëjta dorë, pasi nisur nga lloji i shkrimit, plotësimi i rubrikave, menyra e llogaritjes me presje dhjetore te shumes pa TVSH, TVSH-ja dhe me TVSH, si dhe viza e mbylljes me nderprerje ne pjesen e IBAN-it, duket shume qarte se ato jane plotesuar nga e njejta dore. Pra, sa i takon faturës objekt gjykimi, duket shume qarte se kemi të bëjmë me një fature fiktive, false, të prodhuar nga vetë subjekti “****”, me NIPT ***, pasi kurre nuk është firmosur nga z. ***. Përveç kësaj, kemi të bëjme me një faturë për një mall apo sherbim qe nuk eshte blere(konsumuar) nga pala e paditur. Sipas palës së paditur padia bie në kundërshtim me parashikimin e miratuar nga ligjvenesi ne nenin 137, germa “a” te ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit ...”, ku shprehimisht thuhet se: “AAK-të, ..., kanë këto funksione: a) t’u japin përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë”. Pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë kontrate te shkruar te lidhur me palen e paditur per vitin 2017 per mallin apo sherbimin e shitur te pretenduar ne padi.**

Sipas palës së paditur nuk ka asnjë kërkesë me shkrim nga pala e paditur për këtë mall apo sherbim të pretenduar se është shitur nga pala paditëse. Pala qe pretendon nje te drejte ka barren e proves qe te provoje pretendimet e saj, ndaj ne mungese te kontrates se shkruar mes paleve, padia duhet te rrezohet si e pambeshtetur ne prova dhe ne ligj. Mungesa e nje marredhenie detyrimi mes paleve u provua edhe nga heqja dore nga

Fatura tatimore e shitjes Nr. *, date *** me Nr. serie *** ne vleren *** Lekë, çka passjell rrezimin e padise.**

Paditesi nuk mund të mbrojë në gjykatë interesa te paligjshme. Në kushtet kur vetë pala paditëse heq dore nga Fatura tatimore e shitjes Nr. *, date *** me Nr. serie *** si prova themelore e saj, atehere ajo nuk mund te vije perpara gjykates me padi dhe te kerkoje kthimin e shumes se kesaj fature ne vleren *** Lekë pasi nuk legjitimohet te mbrojtje te interesave te paligjshme, derisa kjo fature rezulton te jete fiktive, çka e detyroi palen paditëse qe te heqe dore nga fuqia provuese e saj. Pala paditëse nuk ka paraqitur asnje prove nepermjet se ciles te mund te vertetonte pretendimet e saj qe, pala e paditur te jete ne kushtet e nenit 131/1 te ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit ...”, “Administrimi kolektiv i detyrueshem”, pasi nuk ekziston asnje prove shkresore tek rrethi i provave te paraqitura nga pala paditëse qe te mund te vertetonte faktin se ne ambientet e subjektit “****” shpk gjate vitit 2017 te jete konsumuar(perdorur) mall apo sherbim ne vleren e pretenduar nga paditesi prej *** Lekë me TVSH. Ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, nga gjendja e faktit ne terren rezulton se pala e paditur shoqeria “****” shpk eshte e lidhur me sistemin kabllor te ofruar nga subjekti *** dhe *** dhe me abonim me karte perfiton sherbimet e tyre, duke qene keshtu ne kushtet e nenit 131/2 te ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit ...”, i cili parashikonse: “2. Dispozitat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk do të zbatohen për ritransmetim kabllor, kur ajo ka të bëjë me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, në lidhje me transmetimet e veta, pavarësisht nëse të drejtat në fjalë janë të vetat ose i janë transferuar asaj nga mbajtësit e tjerë të së drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të. Per kete arsye padia duhet te rrezohet plotesisht, pasi ne baze te nenit 12 te KPC paditesi ka barren e proves qe te provoje pretendimet e tij. Me rrezimin e kerkimit kryesor bien edhe kerkimi i dyte dhe i trete, si te ndërvarura nga kerkimi i pare. Ky fakt u provua nga heqja dore nga Fatura tatimore e shitjes Nr. ***, date 27.9.2017 me Nr. serie *** ne vleren 17.980 Lekë.**

Pala e paditur ka pretenduar se Fatura Tatimore e Shitjes Fatura Nr. *, date 27.09.2017 me Nr. serie *** me shumen 17.980 Lekë me TVSH eshte nje fature e njeanshme, fiktive, false, e prodhur nga vete subjekti “****”, pasi nuk eshte firmosur dhe vulosur nga subjekti “****” shpk me administrator z. *** dhe se eshte shkrim i njejte me faturen tjeter te shlyer tashme Nr. ***, date 27.9.2017 me Nr. serie *** me vlere *** Lekë me TVSH, kerkojme nga Gjykata thirrjen e nje ekspertit kriminalist grafik nga Policia Shkencore Tirane.**

Perfundimisht, pales paditëse nuk i eshte cenuar asnje e drejte ose interes i ligjshëm nga pala e paditur, ndaj kerkimet ne padi nuk gjejne mbeshtetje ne ligj dhe ne prova, fakt qe passjell automatikisht rrezimin e padise.

Në këtë kontratë, palët kontraktuese kanë marrë përsipër me vullnet të lirë me anë të përfaqësuesve të tyre ligjor përmbushjen e detyrimeve përkatëse duke qenë dakort me kushtet e vëna dhe të sanksionuara në këtë kontratë.

Në nenin 419 të Kodit Civil parashkohet se

Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditori), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t’i jepet diçka, ose

të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

Në nenin 450 të Kodit Civil parashkohet se

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, me monedhën zyrtare të vendit ku bëhet pagimi. Përqindja e kamatës caktohet me ligj. Në mbarim të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës së detyruar mbi bazën e të cilës është bërë llogaritja e tyre. Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori të provojë ndonjë dëm. Kur kreditori provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori detyrohet t'i paguajë atij pjesën tjetër të dëmit.

Në neni 452 të Kodit Civil parashkohet se

Kur detyrimi lidhet me pagesën e një shume parash në monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku duhet të kryhet pagesa dhe debitori pretendon se nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin në këtë monedhë, kreditori mund të pranojë shlyerjen në monedhën e vendit të kryerjes së pagesës. Rregulli i mësipërm zbatohet edhe kur debitori detyrohet të bëjë pagesën me monedhën e pranuar në fillim.

Në nenin 453 të Kodit Civil parashkohet se

Kur detyrimi duhet të ekzekutohet me një monedhë të ndryshme nga ajo e pranuar në fillim, konvertimi duhet të bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të ditës së pagimit.

Në neni 462 të Kodit Civil parashkohet se

Kreditori nuk mund të detyrohet të pranojë një gjë të ndryshme nga sa është përcaktuar në objektin e detyrimit edhe sikur vlefte e gjësë së ofruar të jetë më e madhe.

Në nenin 463 të Kodit Civil parashkohet se

Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërimit.

Neni 107 Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” parashikon se

Statusi juridik.

1. Autoret, interpretuesit/ekzekutuesit, prodhuesit e fonogrameve dhe mbajtesit e tjere te se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura gezojne te drejten te krijojne agjenci per administrimin kolektiv te te drejtave te tyre pasurore (ne vijim, agjencite e administrimit kolektiv). AAK-te jane persona juridike, te cilet krijohen dhe funksionojne sipas dispozitave te meposhtme te ketij ligji dhe ne perputhje me licencen e dhene nga ministri pergjegjes per kulturen, kane si qellim mbledhjen dhe

shperndarjen e te ardhurave qe vijne nga perdorimi i veprave te autoreve dhe mbajtesve te te drejtave te lidhura, si edhe perfaqesim ligjor ne cdo proces ligjor administrativ, civil dhe penal.

2. Pervec rasteve kur administrimi kolektiv i se drejtes se autorit ose te drejtave te lidhura parashikohet shprehimisht nga dispozita te ketij ligji, prezumohet qe deri ne shprehjen e vullnetit me shkrim per te dale nga AAK-te dhe administrimi kolektiv, agjencia eshte e vetmja titullare e ligjshme per te ushtruar dhe perfaqesuar te gjitha te drejtat sipas pikes 1 te ketij neni.

Neni 130 i Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to” parashikon se

Administrimi kolektiv i te drejtave te autorit mund te perfshije: b) të drejtën e riprodhimit (regjistrimi audio) të veprave muzikore, c) të drejtën e shpërndarjes, përfshirë të drejtën për qira dhe të drejtën e shpërblimit, sipas parashikimeve të këtij ligji; ç) të drejtën e shpërblimit për huadhënie publike; d) të drejtën e rishitjes, kur veprat origjinale të artit janë duke u rishitur; dh) të drejtën për shpërblim për riprodhimin e veprës për qëllime private ose përdorimi personal; e) të drejtën për shpërblim,

Administrimi kolektiv i të drejtave të prodhuesve të fonogramit mund të përfshijë: a) të drejtën për të vënë fonogramin në dispozicion të publikut; b) të drejtën për shpërblim për transmetimin dhe përcjelljen në publik të fonogramit; c) të drejtën e qirasë së fonogramit; ç) të drejtën për huazim publik të fonogramit; d) të drejtën e shpërblimit për riprodhim të fonogramit për qëllime private ose përdorim personal.

Neni 131 Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to” parashikon se

Administrimi kolektiv i detyrueshëm

1. Në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji, të drejtat në vijim ushtrohen nëpërmjet administrimit kolektiv në mënyrë të detyrueshme, të drejta si: a) e drejta e transmetimit dhe ritransmetimit për autorët dhe interpretuesit, referuar përcaktimit në pikat 1, shkronja “a”, dhe 2, shkronja “c”, të nenit 130, të këtij ligji; b) e drejta e ritransmetimit, e përmendur në shkronjën “f”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji; c) e drejta për shpërblim për transmetim për prodhuesit e fonogrameve, referuar përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 130, të këtij ligji; ç) e drejta e qiradhënies për autorët dhe për veprat/regjistrimet muzikore, për interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve, referuar në pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “d”, dhe 3, shkronja “c”, të nenit 130, të këtij ligji; d) e drejta e shpërblimit për huadhënien publike për autorët, interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve, referuar në pikat 1, shkronja “ç”, 2, shkronja “dh”, 3, shkronja “ç”, dhe 4, shkronja “a”, të nenit 130, të këtij ligji; dh) e drejta për shpërblim për riprodhimin e kopjeve private dhe përdorimit tjetër personal për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit (producentët) e filmave dhe botuesve, referuar në pikat 1, shkronja “dh”, 2, shkronja “e”, 3, shkronja “d”, 4, shkronja “b”, dhe 5, të nenit 130, të këtij ligji; e) e drejta për një shpërblim, e përmendur në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 130, të këtij ligji; ë) e

drejta e rishitjes së origjinaleve të veprave të artit, referuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

Objekti i padisë është përmbushja e detyrimit kontraktor, prandaj duhet të shikohet nëse ekziston ndonjë marrëdhënie juridike midis palëve dhe cili është detyrimi që është premtuar të realizohet.

Detyrimet krijohen me kontratë ose me ligj. Në rastin konkret kemi një detyrim të krijuar me ligj dhe pala paditëse ka kërkuar nga pala e paditur përmbushjen e detyrimit. Në analizë ligjore të përgjithshme gjykata vlerëson se fatura tatimore objekt gjykimi Fatura Tatimore e Shitjes Nr. * date 27.09.2017 në shumën *** Lekë është e paqartë në lidhje me palën paditëse. Pala e paditur ka deklaruar Fatura tatimore e Shitjes me Nr. *** date 27.09.2017 nuk është nënshkruar fare nga blerësi. Poshtë rubrikës së saj të shënuar “BLERËSI”, nuk është nënshkruar nga asnjë përfaqësues i shoqërisë paditëse.**

Gjykata arsyeton se Ligji 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” ka parashikuar lindjen e detyrimeve për një kategori të caktuar subjektesh tregtare në lidhje me të drejtat e autorit. Autorët, interpretuesit/ekzekutuesit, prodhuesit e fonogrameve dhe mbajtesit e tjere te se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura gezojne te drejten te krijojne agjenci per administrimin kolektiv te te drejtave te tyre pasurore (ne vijim, agjencite e administrimit kolektiv). AAK-te jane persona juridike, te cilet krijohen dhe funksionojne sipas dispozitave te meposhtme te ketij ligji dhe në perputhje me licencen e dhënë nga ministri përgjegjës për kulturën, kanë si qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e te ardhurave qe vijne nga perdorimi i veprave te autoreve dhe mbajtesve te te drejtave te lidhura, si edhe perfaqesim ligjor ne cdo proces ligjor administrativ, civil dhe penal.

Gjatë shqyrtimi gjyqësor gjykata ka vlerësuar se fatura tatimore është e paqartë në lidhje me palën paditëse. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se pala e paditur nuk e njeh dhe nuk e ka pasur ndonjëherë këtë faturë tatimore shitjeje në librat e saj financiar. Sipas palës së paditur nuk rezulton që subjekti “**” sh.p.k të jetë pajisur me këtë faturë, as ta ketë nënshkruar atë, si dhe nuk rezulton që kjo faturë të jetë deklaruar në Librin e Blerjeve te muajit Shtator – Dhjetor të vitit 2017 të subjektit “****” shpk prane Drejtorise Rajonale te Tatimeve Tirane, siç e tregojnë Librat e Blerjeve për periudhen Shtator 2017 – dhjetor 2017 qe ndodhen bashkelidhur Shkresës Nr. ***prot, date *** te DRT Tiranë. Në Librin e Blerjeve te muajit Nëntor 2017 ekziston Fatura Nr. ***, date 27.9.2017 me Nr. Serie *** me shitës ***dhe bleres subjekti “****” shpk ne vleren *** Lekë me TVSH, e cila ndryshon sa i takon subjektit shites dhe vleres se shitur. Rezulton se me mandat arketimin e dates *** prane *** Bank nga ana e pales paditëse është shlyer plotësisht kjo faturë në shumën ***Lekë.**

Sic rezulton sa më sipër pala e paditur ka paguar Fatura Nr. *, date 27.9.2017 me Nr. Serie *** me shitës ***dhe bleres subjekti “****” shpk ne vleren *** Lekë me TVSH. Pala e paditur ka përmbushur detyrimin e saj ligjor në lidhje me Ligji 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Mirëpo pala paditëse i ka dërguar një faturë tjetër e cila është fatura objekt gjykimi. Kjo faturë nuk është e regjistruar në aktet kontabile të palës së paditur dhe më pas të deklarohet në organet**

tatimore.

Së pari gjykata konstaton se në rastin objekt gjykimi nuk është sqaruar lidhja midis palës paditëse dhe shitësit të shërbimeve sic është Agjencia përkatëse për tekstshkruesit dhe kompozitorët. Pala paditëse ka pranuar se pala e paditur ka kryer pagesën e te drejtes se autorit per producentet (***) dhe nuk ka likujduar pagesën vjetore për *** si agjencia që mbledh detyrimet për tekstshkruesit dhe kompozitorët, e cila është detyrim i cdo subjekti perdorues i te drejtes se autorit.

Mirëpo bazuar ne nenin 138 te Ligjit Nr.35/2016 datë 31.03.2016 për “Të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” agjencite e te drejtave te autorit duhet te bien dakort per krijimin e sportelit unik, ku të transferojnë funksionet e mbledhjes se të gjitha tarifave të të gjitha kategorive pra: a) tarifën per agjencine e të drejtës se autorit (***) që perfshin kompozitorët dhe tekstshkruesit), b) tarifën për agjencine e te drejtave te producenteve (që është Agjencia e Mbrojtjes Intepretuesve), c) tarifën per agjencine e mbrojtjes se te drejtave te prodhuesve (***)).

Kjo mënyrë e shlyerjes së detyrimeve është e paqartë për subjektet tregtare. Deri në krijimi ne një sporteli unik për mbledhjen e të drejtave të autorit, mënyra sesi ka vepruar pala paditëse apo edhe agjencitë e tjera mbi të drejtën e autorit ka qenë e paqartë dhe jo në zbatim të plotë me ligjin mbi të drejtat e autorit. Gjykata nuk vënë në diskutim personalitetin juridik apo edhe pozicion ligjor të palës paditëse apo edhe agjencive të tjera të cilat administrojnë të drejtat e autorit. Mirëpo mënyra sesi kanë vepruar si agjenci të ndara, duke paraqitur fatura të njëjta tek subjektet tregtare ka sjellë një situatë të tubullt ligjore në lidhje me këto fatura.

Duke qenë se këto probleme janë evidentuar edhe më parë, këto kompetenca te agjencive jane deleguar me anë të Vendimit Nr.4 datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to drejt njëjës prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit-SUADA. Pra para kësaj datë kompetencen për mbledhjen e te drejtave te autorit e kishin tre agjencite e siperpërmendura, duke pasjellë një situatë konfuze nga pikpamja ligjore për subjektet tregtare. Ndërsa Vendimit Nr.4 datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to drejt njëjës prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit-SUADA ofron një mënyrë veprimi dhe sjelljeje tërësisht ligjore. Fakti që pala e paditur ka kryer likujdimin Për të drejtat e autorit, për Agjencine e Mbrojtjes së Producentëve, vërteton që ajo ka shlyer detyrimin e saj në lidhje me detyrimet mbi të drejtat e autorit. Mirëpo paraqitja e disa agjencive me fatura të njëjta si procedurë shlyerje detyrimesh para Vendimit Nr.4 datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, për gjykatën është një praktikë e gabuar dhe nuk duhet të përsëritet më në të ardhmen. Tashmë me anë të këtij vendimi mënyra e shlyerjes së detyrimeve sipas Ligjit Nr.35/2016 datë 31.03.2016 për “Të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” me anë të një sporteli Unik është një procedurë tërësisht në përputhje me ligjin dhe nuk lë asnjë hapësirë për abuzime apo keqinterpretime nga asnjë subjekt tregtar. Duke qenë se ky vendim nuk ka fuqi prapavepruese, gjykata cmon se mënyra e

mëparshme e faturimit sipas agjencive të ndryshme të të drejtave të autorit nuk është në përputhje as me frymën dhe as më gërmën e Ligjit Nr.35/2016 datë 31.03.2016 për “Të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Nga ana tjetër duke iu referuar pretendimeve të palëve ndëgjyqëse, gjykata konstaton se kjo faturë tatimore ka disa probleme ligjore. Për këtë arsye gjykata do ti referohet Ligj Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, çdo furnizim malli apo shërbimi dokumentohet në përputhje me përcaktimet e ligjit për TVSH-në. Dokumenti bazë që përdoret është fatura tatimore. Ajo përcakton detyrimin e TVSH-së për furnizuesin dhe shumën e TVSH-së të zbritshëm që do ti lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH-në. Bazuar në nenin 97 të këtij ligji fatura tatimore është e detyrueshme të lëshohet: Për çdo furnizim malli ose shërbimi të kryer kundrejt një personi të tatueshëm ose një personi juridik të pa-tatueshëm; Për çdo pagesë të arkëtuar përpara se të kryhet furnizimi i mallit ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimit. Në raste të caktuara, për të dokumentuar furnizimin e mallit apo shërbimit përdoren dokumente tatimore të thjeshtuara si p.sh kuponi tatimor, i cili në mënyrë të detyruar përmban elemente të përcaktuara në ligj. Kuponi tatimor është i detyrueshëm të lëshohet në çdo rast që transaksioni nuk është i detyruar të shoqërohet me faturë tatimore me TVSH-në për transaksione me vlera deri në 40.000 lekë të kryera për individë, përveç kur blerësi individ kërkon faturën tatimore. Për çdo furnizim të tillë të bërë për individët konsumatorë jo-tregtarë, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet detyrimisht emri, mbiemri dhe adresa e blerësit. Ndërkohë që në konfliktin objekt gjykimi kemi të bëjmë me dy subjekte tregtare.

Fatura tatimore duhet të përmbajë të gjithë informacionin e përcaktuar sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe konkretisht:

datën e lëshimit të faturës;

një numër serial që e identifikon faturën në mënyrë unike;

numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve;

numrin e identifikimit të TVSH-së të blerësit, kur ai është person i tatueshëm për furnizime brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

emrin dhe adresën e plotë të shitësit dhe të blerësit;

emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit;

sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera;

datën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer ose datën, në të cilën pagesa është kryer, në qoftë se kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;

çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar, si dhe çdo ulje të çmimit ose zbritje që nuk është përfshirë në çmimin për njësi;

vlerën e tatueshme, sipas shkallës tatimore të zbatuar ose të përjashtuar;

shkallën e zbatuar të TVSH-së, të shprehur në përqindje;

vlerën e TVSH-së së pagueshme, përveç rasteve kur zbatohet një regjim i veçantë, sipas të cilit, në përputhje me ligjin, kjo vlerë nuk duhet të tregohet në faturë;

vlerën totale me TVSH.

Përveç sa më sipër, për disa raste fatura duhet të përmbajë edhe informacionin si më poshtë

kur fatura është lëshuar për pagesë të kryer në avancë dhe TVSH-ja bëhet e

kërkueshme në momentin e marrjes së pagesës, si dhe e drejta e zbritjes lind në këtë moment, në faturë duhet të shkruhet “Pagesë në avancë”;

kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimin e marrë nga furnizuesi në faturën e lëshuar duhet të shkruhet “Vetëfaturim”;

në rast se personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime të përjashtuara nga TVSH-ja, fatura duhet të tregojë dispozitën e këtij ligji, sipas së cilës përjashtohet; në rast se personi i tatueshëm në cilësinë e blerësit apo klientit është përgjegjës për pagesën e TVSH-së, në faturë duhet të shkruhet “auto-ngarkesë e TVSH-së”(reverse-charge);

në rast të zbatimit të regjimit të veçantë për agjencitë e udhëtimit, në faturë duhet të shkruhet “TVSH- ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit”;

në rast të zbatimit të njërit prej regjimeve të veçanta për mallrat e përdorura dhe për objektet e artit, koleksioneve ose antikitetit, në faturë duhet të shkruhet respektivisht “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i mallrave të përdorura”; “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e artit”; “TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e koleksioneve dhe antikitetit”;

në rast se personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një përfaqësues tatimor, duhet të tregohet në faturë numri i identifikimit të TVSH-së të përfaqësuesit tatimor, së bashku me emrin dhe adresën e tij të plotë.

Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se fatura tatimore e shitjes ka probleme në anën e saj formale pasi nuk plotëson kriteret e mësipërme sipas Ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Pala e paditur nuk ka paraqitur një listë të detajuar të mallrave që ka shitur me anë të kësaj fature tatimore shitjeje. Sipas Ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” fatura tatimore e shitjes duhet të përmbajë sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera. Mirëpo në rastin konkret fatura object gjykimi nuk përmban aktin normative që përcakton metodikën e përlllogaritjes së detyrimit monetar të palës së paditur në zbatim të Ligjit Nr.35/2016 datë 31.03.2016 për “Të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Mbrojtja e të drejtave të autorit është në një fazë relativisht të fillestare dhe përvec inkurajimit të fortë në lidhje me këtë pjesë të rëndësishme të të drejtave të autorit, duhet që mënyra e mbledhjes së të drejtave të autorit duhet të rregullohet në një mënyrë të plotë dhe transparente. Pala paditëse duhet të shoqërojë faturat përkatëse me mënyrën e përlllogaritjes së detyrimit pasi cdo subject ka specifikat e tij tregtare (madhësia, sipërfaqe, aktivitetit, etj) dhe nuk mund të jepen standarte në përgjithësi për të gjithë.

Për aq kohë sa në procesin gjyqësor nuk janë paraqitur prova shkresore në lidhje me metodikën dhe mënyrën e përlllogaritjes së faturës përkatëse, gjykata arrin në konkluzionin se kjo faturë nuk janë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Duke hetuar dhe analizuar këtë faturë tatimore shitjeje gjykata arrin në konkluzion se kjo faturë tatimore shitjeje ka probleme provueshmërie për të provuar një transaksion tregtar në përputhje me legjislacionin tatimor. Për gjykatën, nga këto dokumente shkresore nuk mund të krijojnë asnjë pasojë juridike dhe ekonomike për palët ndërgjyqëse. Këto akte shkresore nuk kanë elementet dhe ekstremitetet ligjore që duhet të kenë faturat sipas akteve normative të mësipërme.

Sa më sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e palës paditëse është e pa mbështetur në ligj dhe në prova, pasi pala paditëse nuk ka arritur të provojë

pretendimin e pagesave të lidhura nga marrëdhënia juridike e detyrimit si një kontratë furnizimi sipas dispozitave ligjore. Parashkrimi i kërimit të së drejtës pr përmbushje të detyrimit kontraktor dhe problemet ligjore në anën formale ligjore të Faturave objekt gjykimi i kanë krijuar bindjen gjykatës së kjo padi duhet rrëzuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenin 126 të Kodit të Procedurës Civile,
VENDOSI

Rrëzimin e padisë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditese.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjete) diteve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë me 10 Nëntor 2020.

**Sekretare
Gjyqtar**

**Kludia ABAZAJ
Julian HAXHIU**

Shpenzime gjyqësore	Pala që ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor				Sasi	Çmim	Vlerë
	Gjykata	Paditës	I Paditur	P.tretë			
Taksë padie		3000			1	3000	3000
Perfaqesim ligjor-paditesi		48000			1	48000	48000
Perfaqesim ligjor-pala paditur			84000		1	84000	84000
Shpenzime për njoftime	900				6	150	900
Shuma	900	51000	84000	0			135900 Leke